




kasko2go



kasko2go: «Startup», firmë nga Zugu, po e përzier industrinë e sigurimeve.

App i ri i sigurimit të makinave zbrit preminë deri në 50% dhe siguro më shumë Drejtësia dhe siguria

Zug, 24 prill 2019, **varësisht moshës ose kombësisë suaj, ju paguani për sigurimin e automjetit tuaj deri në 95% më shumë se të tjerët. Prandaj kasko2go lanson sot së bashku me partnerin e saj «Dextra Versicherungen» AG zgjidhje bashkëkohore dhe më të drejtë, që lejon të gjithë shoferët e makinave të kursejnë deri në 50% të premisë duke u bazuar në mënyrë individuale; në sjellje gjatë vozitjes dhe në kilometrat e vërteta të vozitura.**





kasko2go

Sigurimi i makinës me App **kasko2go** përdor inteligjencën artificiale dhe teknologjinë e telematikës mobile, vlerëson rrezikun individual dhe kështu shpërblen përgjegjësin e njëherë siguron vozitësen/in.

Nga ky qytet Zug ka nisur «Startup» firmën **kasko2go** për të revolucionarizuar industrinë e sigurimeve.

kasko2go ka zgjidhje; me teknikë inovative synon të promovojë një kulturë në vozitje të sigurt në shoqëri, për të siguruar drejtësi më të madhe dhe njëkohësisht të zvogëlojë çmimet e fryra të premive të automjeteve.

Pse sigurimet e automjeteve nuk kanë skemën e vet të sigurimit për premitë, që të merret parasysh sjellja e vozitjes?



Kjo pyetje nga themeluesit e **kasko2go** është shtruar qysh vite me parë dhe së bashku me shkencëtarët e inxhinierët kanë projektuar një zgjidhje pikërisht për këtë. Pas disa viteve të përgatitjes **kasko2go** dëshiron gjithashtu edhe tregun zviceran ta mposhtë dhe ka hyrë në një partneritet afatgjatë me «Dextra Versicherung» AG. Nga tani e tutje aplikacioni zviceran «App» i **kasko2go** është në të gjitha platformat falas për shkarkim (Android / iOS). Përdorimi është i thjeshtë:

Shkarko App (aplikacionin), futni të dhënat, zgjidhni tarifën, shpengoni makinën, vozitni më tutje dhe kurseni.

Pagesa është mujore, për ngasje të sigurt do të shpërbleheni me një pagesë mbrapa.



kasko2go



Më shumë drejtësi: Shqiptarët sot paguajnë deri në 95% më shumë

Disa grupe njerëzish sot në Zvicër, duke u bazuar në kombësinë e tyre ose në moshën, paguajnë më shumë për sigurimin e makinës, duke mos e marrë parasysh sjelljen individuale të vozitësit.

Sipas një studimi të [Comparis.ch](https://www.comparis.ch), për shembull, shtetasit shqiptarë paguajnë varësisht kompanisë së sigurimeve për sigurimin e njëjtë deri në 95% më shumë për preminë sesa zviceranët. Shoferët e sigurt dhe të vëmendshëm duhet të shpërblehen me premi të ulëta pavarësisht nacionalitetit dhe moshës së tyre. Vetëm si mund ta njohim këtë të besueshme?

Falë teknologjive të IT-së dhe të dhënave telematike sot është e mundur që vazhdimisht të vlerësohet stili i ngasjes së makinës për çdo individ në përputhje me rrethanat e vozitjes, thotë CEO i **kasko2go**, Genadi Man.

Pas disa viteve të përgatitjes unë jam i kënaqur të ofroj qasjen tonë të drejtë për të gjithë konsumatorët në Zvicër.

Më shumë siguri në rrugë

Më shumë se 56.000 aksidente, mbi 20.000 të plagosur dhe 230 të vdekur. Ky është rekord i trishtuar. Bilanci i aksidenteve zvicerane të zyrës federale të rrugëve ASTRA.

Shkaku i aksidentit sipas ASTRA-s në shumicën e rasteve vjen nga një sjellje e keqe nga ana e shoferit, si tejkalimi i shpejtësisë së duhur ose moskujdesia në ngasje. Aplikacioni kasko2go llogarit preminë e sigurimit të makinës duke u bazuar në stilin tuaj personal të vozitjes dhe vendos kështu nxitje të një vozitjeje të sigurt.

Nëse ju vozitni me vëmendje, në formë të rregullave dhe me energji efieience do të jeni me mbrojtje optimale, si dhe do të shpërbleheni me premi të ulët dhe të drejtë.

Kështu që kurseni para, përmirësoni sigurinë në trafikun zviceran dhe lehtësoni mjedisin - një situatë e favorshme për të gjithë të interesuarit.



kasko2go

Rreth kasko2go AG

kasko2go është një ofrues inovativ i zgjidhjeve të sigurimit, që dëshiron të promovojë kulturë në vozitje të sigurt në shoqëri. Falë vlerësimeve të AI-së të posaçme të zhvilluara dhe telematike BIG-DATA të të dhënave, me «Pay As-you-drive» dhe «Pay-How-You-Drive» modele, kasko2go ul preminë e sigurimit deri në 50 për qind.


Që nga prilli 2019 kasko2go së bashku me partnerin e sigurimeve «Dextra2» ofron në Zvicër një aplikacion – sigurim revolucionar të makinës, i cili llogarit preminë e sigurimit të automjetit duke u bazuar në sjelljen personale të vozitësit.

Në mbarë botën kasko2go tashmë ka më shumë se 150.000 klientë, të cilët përdorin këtë sistemin inovativ. Kompania me qendër në Zug u themelua në vitin 2017 dhe punëson mbi 60 vetë

Punonjësit brenda grupit përfshijnë shumë inxhinierë, shkencëtarë dhe specialistë të sigurimit www.kasko2go.com.

Rreth «Dextra Insurance» AG

«Dextra Versicherungen» AG, me seli në 8048 Zurich, është një sigurim i ri dhe inovativ zviceran 2016, i bazuar në «Kassensturz», fitues i testit «Dextra Rechtsschutz» AG. Ajo bën shitjen



e sigurimin e makinave në Zvicër që prej 1.1.2018. Analiza të shumta dhe analiza produkteve (për shembull «Saldo Comparis», SIQT) tregojnë mbrojtjen gjithëpërfshirëse dhe shërbimin e shkëlqyeshëm të konsumatorëve të sigurimit «Dextra» AG. Informacione të mëtejshme rreth sigurimit «Dextra» AG ose «Dextra Rechtsschutz» (Mbrojtja ligjore) AG në www.dextra.ch



<https://itunes.apple.com/ua/app/kasko2go/id1457551509>



<https://play.google.com/store/apps/details?id=com.kasko2go.switzerland>



<https://kasko2go.com>